



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 02.02.2026

V E N D I M

Nr.1, datë 02.02.2026

**PËR
“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E MODELIT TË
PËRMBLEDHJES SË KONTRATËS PËR T’U PËRDORUR NGA OFRUESIT E
SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 02.02.2026, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Rregullores “Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike””

BAZA LIGJORE:

1. Pika 6 e Nenit 141 të Ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 54/2024);
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit pas procedurës së këshillimit publik:
 - a. *“Rregullore për Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”;*
 - b. *“Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të Projekt-Rregullores për Modelin e Përmbledhjes së Kontratës”*
 2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
 3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 01, datë 19.03.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim publik *“Rregullore për Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike- Dokument për Këshillim Publik”*. Ky dokumenti u hartua dhe u publikua për këshillim publik nga AKEP në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr.54/2024 *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”* i cili hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar Ligjin 9918/2008.
2. Ligji i ri 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit *“Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”* (në vijim EECC), dhe përmban një sërë përcaktimesh në lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Një e drejtë e shtuar për konsumatorët është pajisja e tyre nga ofruesi i shërbimit me dokumentin e Përmbledhjes së Kontratës:
 - Sipas pikës 5 të Nenit 141 të Ligjit 54/2024, *Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, duhet t’u vënë në dispozicion konsumatorëve një përmbledhje të shkurtër dhe lehtësisht të lexueshme të kontratës. Kjo dispozitë ligjore përmban dhe elementët kryesorë që duhet të përmbajë përmbledhja e kontratës si a) emri, adresa dhe detaje të kontaktit të ofruesit dhe, nëse është i ndryshëm, dhe detajet e kontaktit për ankesat; b) karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar; c) çmimet përkatëse; ç) kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj; d) masa në të cilën produktet dhe shërbimet janë të projektuara për përdoruesit fundorë me aftësi të*

kufizuara; dh) në lidhje me shërbimet e aksesit në internet, një përmbledhje të informacionit të kërkuar, sipas shkronjave “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 178 të këtij ligji.

- Sipas pikës 6 të nenit 141 të Ligjit 54/2024, Ofruesit e shërbimit, që janë objekt i zbatimit të detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, plotësojnë në mënyrën e duhur modelin përmbledhës të kontratës me informacionin e kërkuar, në përputhje me rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe pajisin konsumatorin me përmbledhjen e kontratës, pa pagesë dhe përpara lidhjes së kontratës, përfshirë për kontratat në largësi.

3. Dokumenti “Rregullore për Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike- Dokument për Këshillim Publik”, i miratuar me VKD nr.1, datë 19.3.2025, u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 26.03.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 26.04.2025. Në përfundim të procesit të këshillimit publik në AKEP depozituan komente palët e interesuara si më poshtë:

- Sipërmarrësi One Albania sh.a., me shkresën Nr.980 Prot., datë 25.04.2025 (Ref.AKEP: Nr.749 Prot, datë 28.04.2025);
- Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., me shkresën me referencë LEA/030/L.R/E.M, datë 23.04.2025 (Ref.AKEP: Nr. 749/1 Prot, datë 28.04.2025).

AKEP më datë 16.12.2025 zhvilloi dhe një seancë diskutimi/sqarimi me palët e interesuara në lidhje komentet e depozituara sa më sipër për *Projekt-Rregulloren për Modelin e Përmbledhjes së Kontratës*.

4. AKEP pas vlerësimit të komenteve të palëve të interesuara për dokumentin e *Projekt-Rregulloren për Modelin e Përmbledhjes së Kontratës* së nxjerrë në këshillim publik ka përgatitur dokumentat e mëposhtëm:

- a. “Rregullore për Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” që përbën dokumentin përfundimtar pas procesit të këshillimit publik, si dhe
- b. “Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të *Projekt-Rregullores për Modelin e Përmbledhjes së Kontratës*”, që përmban komentet e palëve të interesuara gjatë procesit të këshillimit publik të *Projekt-Rregullores* si dhe qëndrimet e AKEP për komentet.

5. Dokumenti “Rregullore për Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”:

- përcakton Modelin e Përmbledhjes së Kontratës së pajimit, përfshirë:
 - rregullat përkatëse për prezantimin e informacionit/përmbajtjes, si dhe
 - udhëzimet përkatëse detyruese për plotësimin e saj,

të cilat duhet të përdoren nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, për zbatimin detyrimeve ligjore për pajisjen e përdoruesve fundorë me dokumentin e përmbledhjes së kontratës sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 141 të Ligjit 54/2024.

- është përafuar plotësisht, në strukturë dhe përmbajtje, me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243;¹
 - është një dokument i rëndësishëm rregullator i përgatitur në kuadër të hartimit nga AKEP të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e ligjit 54/2024, dhe
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të pikave 5 dhe 6 të nenit 141 të Ligjit 54/2024.
6. Dokumenti “*Rregullore për Përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*” përbën një element të rëndësishëm të kuadrit rregullator për zbatimin e Ligjit 54/2024, që mundëson pajisjen e konsumatorëve/përdoruesve fundorë nga ofruesit e shërbimeve komunikimeve elektronike publike me informacion konciz dhe lehtësisht të krahasueshëm para-kontraktual të elementëve kryesorë të kontratës së pajtimit, nëpërmjet përdorimit të Modelit të Përmbledhjes së Kontratës, i hartuar nga AKEP në përputhje/përafrim të plotë me modelin e aplikuar në të gjitha vendet e BE-së/Rregullore (BE) 2019/2243.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë:
 - a. *Rregullore “Për përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*, dhe
 - b. *“Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të Projekt-Rregullores për Modelin e Përmbledhjes së Kontratës”*
- sipas dokumentave bashkëlidhur;

¹ Rregullore Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/2243 e datës 17 dhjetor 2019 që përcakton një model për përmbledhjen e kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun në përputhje me Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. CELEX_32019R2243, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 336, datë 17.12.2019, f. 274-280.

2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka